




REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK



Nr. Prot.

Vlorë, më 06.12.2017

Vendim
Nr. 98, datë 06.12.2017

PËR GODINËN E RE TË FSHP-së

Mbështetur në nenin 3 dhe nenin 38 në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe referuar Vendimit nr. 16, datë 27.01.2017 të Senatit Akademik, Senati Akademik në mbledhjen e datës 06.12.2017

VENDOSI:

1. Pas kryerjes së studimit të fizibilitetit dhe praktikave ligjore nga grupi i punës i ngritur në mbështetje të Vendimit nr. 16, datë 27.01.2017 të Senatit Akademik, të miratojë ngritjen e një godinë e re.
2. Duke qenë se studimi dhe preventivi janë realizuar bazuar në të dhënat për Fakultetin e Shëndetit Publik, kjo godinë të ndërtohet për t'iu përgjigjur nevojave të këtij fakulteti.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Dekani i Fakultetit të Shëndetit Publik, Administratori, Drejtorja e Financave dhe Realizimit të Buxhetit, Sektori Juridik, Sektori i Prokurimeve.
4. Vendimi regjistrohet dhe arkivohet.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI



Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.